

ISSN: 2521-831X

Volumi / Volume Nr.5

Numri / Issue 60

DHJETOR / DECEMBER - 2021

**BULETINI
M U J O R
KLIMATIK**

**CLIMATE
MONTHLY
BULLETIN**

UPT – IGEO

Departamenti i Meteorologjisë

PUT – IGEO

Department of Meteorology



Tirana, Albania © 2021

Gjatë muajit dhjetor më datë 21 shënohet dhe momenti i solsticit dimëror, ku në vendin tonë shënohet dhe dita më e shkurtër, e cila për Tiranën për këtë vit ishte jetë 9 orë e 11 minuta.

During the month of December, on the 21st, the moment of the winter solstice is marked, where in our country the shortest day is also marked, which for Tirana has been 9 hours and 11 minutes.





UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE
Departamenti i Meteorologjisë

Adresa: Rruga "Don Bosko", Nr.60, Tiranë, Tel/Fax: +355 42250601 www: www.geo.edu.al

Viti i 5^{të} i botimit / The 5th year of issues UPT-IGEO / PUT-IGEO  Klima.Shqiperia@gmail.com

BULETINI MUJOR KLIMATIK CLIMATE MONTHLY BULLETIN

DHJETOR / DECEMBER 2021

Nr.60

Përmbledhje. Muaji dhjetor 2021 u karakterizua me temperatura të ajrit paksa mbi vlerat e normës (+0.4°C), ku anomalitë më të theksuara u vrojtuan në temperaturat maksimale të ajrit (+0.9°C). Gjatë muajit dhjetor u vrojtuan dhe reshje shiu e dëbore, të cilat në tërësinë e tyre në shkallë vendi ishin më të larta se norma me +32%, por me një shpërndarje jo të njëjtë hapsinore. Reshjet më të shumta u vrojtuan në pjesët VP e JP të vendit, ndërkohë që krahasuar me vlerat e normës (1961÷1990) ndryshimet më të theksuara të shprehura në % i shënoi zona JL e Shqipërisë. Nuk u vrojtuan dukuri meteorologjike ekstreme dhe me pasoja negative. Sa i takon vlerësimit agrometeorologjik duhet thënë se ky muaj shënoi dhe fundin e periudhës së vegjetacionit në pjesën më të madhe të territorit, si dhe u vrojtuan me vonesë ngricat e para "të vjeshtës" në pjesën e Ulëtisrës Perëndiore. Një vlerësim mbi potencialin që ofron era si burim energjie alternative në hapësirën e pellgut ujëmbledhës të lumit të Drinit të Zi për lartësinë 120 metra mbi sipërfaqen e tokës pasohet me një analizë mbi klimën dhe ndryshimet e saj në 5 vitet e fundit për muajin dhjetor. Në fund një informacion i rëndësishëm shkencor mbi ndryshimet klimatike dhe si paraqitet situata në vende të ndryshme sa i takon treguesit global të rrezikut përmbyll këtë buletin shkencor.

Summary.

Air temperatures characterized December 2021 slightly above the norm values (+0.4°C), where the most pronounced anomalies were observed at maximum air temperatures (+0.9°C). During December, rain and snowfall were observed, which in their entirety nationwide were higher than the norm by +32%, but with a different spatial distribution. The most precipitation was observed in the NW and SW parts of the country, while compared to the norm values (1961÷1990) the SE area of Albania marked the most pronounced changes expressed in %. No extreme meteorological phenomena with negative consequences were observed. Regarding the agrometeorological assessment, should say that this month marked the end of the vegetation period in most of the territory, as well as the first "autumn" frosts were observed late in the part of the Western Lowlands. It follows an assessment of the potential offered by wind as an alternative energy source in the Drini i Zi River catchment area for a height of 120 meters above the ground by an analysis of climate and its changes in the last 5 years for December. Finally, important scientific information on climate change and how the situation is presented in different countries in terms of global risk indicators concludes this scientific bulletin.

TABELA E PËRMBAJTJES / TABLE OF CONTENT

Përmbledhje.....	3	Summary.....	3
Hyrje.....	5	Introduction.....	5
Temperaturat e ajrit.....	6	Air temperatures.....	6
Reshjet atmosferike.....	14	Atmospheric precipitation.....	14
Agrometeorologji.....	24	Agrometeorology.....	24
Energjitë e rinovueshme.....	28	Renewable energies.....	28
Ndryshimet Klimatike.....	29	Climate change.....	29
Informacione shkencore.....	32	Scientific information.....	32



Në datën 21 dhjetor shënohet solstici i dimrit, i cili përcjell dhe kohëzgjatjen më të shkurtër të ditës e për rrjedhojë dhe sasia e rrezatimit diellor që arrin mbi sipërfaqen e Tokës në hemisferën veriore, natyrisht me ndryshime të caktuara sipas gjërësive gjeografike regjistron vlerat më të ulta.

December 21 marks the winter solstice, which follows the shortest duration of the day and consequently the amount of solar radiation that reaches the surface of the Earth in the northern hemisphere, of course with certain changes according to latitude records the lowest values.

Fund viti 2021 përcolli një muaj dhjetor me vlera paksa mbi normë sa i takon temperaturave të ajrit si dhe po ashtu reshje mbi normë. Në tërësi ai ishte më shumë një zgjatje e stinës së vjeshtës, se sa një muaj tipik dimri, pasi tregues si ashpërsia dimërore, ngricat apo temperaturat minimale, dukuri ekstreme të motit, apo reshje të shumta dëbore nuk u vrojtuan. Nuk u vrojtuan thyerje të rekordeve historike dhe as dukuri meteorologjike me pasoja negative mbi veprimtarinë ekonomike apo jetën e njerëzve.

Në tërësi duhet thënë se viti 2021 u mbyll me një regjim të temperaturave të ajrit më të larta se norma, duke u vlerësuar në shkallë kombëtare me një anomali prej $+1.7^{\circ}\text{C}$. Po ashtu interesant është dhe fakti, që për shkak të reshjeve të shumta të

vrojtura në nivele mbi normë në muajt janar veçanërisht si dhe në dhjetor, totali vjetor i reshjeve për vitin 2021 shënoi vlera pranë normës, ndonëse në të njëjtën kohë

duhet thënë se periudha e ngrohtë e këtij viti u shoqërua me anomali negative të reshjeve atmosferike.

Rezultate e përfutuara i referohen dhe bazohen në të dhënat e përfutuara nga rreth 80 deri 100 vendmatje meteorologjike të përpunuara çdo muaj, pjesë të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik të Shqipërisë.

Rezultatet e marra janë verifikuar periodikisht dhe me produktet e ndryshme të platformave rajonale e kontinentale përkatësisht për çdo muaj duke rritur më tej besueshmërinë e përfundimeve të nxjerra dhe publikuara në këtë buletin; i cili synon të japë një vlerësim sa më shkencor si nga pikëpamja meteorologjike për muajin në fjalë ashtu dhe klimatike duke nxjerrë në pah dhe ndryshimet përkatëse me periudhat e referencës në të shkuarën, sipas normës (1961÷1990) ashtu dhe sipas normës së fundit (1991÷2020).

The end of the year 2021 was followed by December with values slightly above the norm in terms of air temperatures and also precipitation above the norm. On the whole, it was more of an extension of the autumn season, than a typical winter month, as indicators such as winter harshness, frosts or minimum temperatures, extreme weather events, or heavy snowfall were not observed. No breaking of historical records or meteorological phenomena with negative consequences on economic activity or human life were observed.


In general, it should be said that the year 2021 was closed with a regime of air temperatures higher than the norm, being evaluated on a national scale with an anomaly of $+1.7^{\circ}\text{C}$. Also

interesting is the fact that due to the numerous precipitations observed at levels above the norm in January especially and in December, the total annual precipitation

for 2021 marked values close to the norm, although at the same time it must be said that the warm period of this year was accompanied by negative anomalies of atmospheric precipitation.

The obtained results refer to and are based on the data obtained from about 80 to 100 meteorological stations processed every month, part of the National Meteorological Monitoring System of Albania.

The obtained results are verified periodically and with the products of different regional and continental platforms respectively for each month, further increasing the reliability of the conclusions drawn and published in this bulletin; which aims to give the most scientific assessment from the meteorological point of view for the month in question and climate, highlighting the relevant changes with reference periods of the past, according both the period (1961÷1990) and the latest one norm (1991÷2020).



Temperaturat e ajrit gjatë muajit dhjetor 2021 shënuan vlera mbi normë si në shkallë globale, ashtu dhe sa i takon kontinentit European, të cilat janë paraqitur dhe në hartat e figurave Nr.1 dhe Nr.2



Air temperatures during December 2021 marked values above the norms both globally and in terms of the European continent, which are shown in the maps of Figures No.1 and No.2.




Figure Nr.1 - Anomalitë e temperaturës së ajrit pranë sipërfaqes për muajin dhjetor 2021 kundrejt periudhës 1991÷2020. / Surface air temperature anomaly for December 2021 compare to the period 1991÷2020 (Copernicus, ECMWF, etc.).

Në nivel global, muaji dhjetor 2021 ishte 0.32°C më i ngrohtë se mesatarja 1991÷2020 për këtë muaj. Ai ishte dhjetori i gjashtë më i ngrohtë në rekorde, megjithëse vetëm pak më i ftohtë se dhjetori i 2016 dhe 2018 dhe afërsisht 0.2°C më i ftohtë se dhjetori 2015 dhe 2019, që konsiderohen dhjetorët më të ngrohtë. Bazuar në këto informacione vendi ynë përgjithësisht ishte me vlera më pranë normës (1991÷2020). Një informacion më i detajuar mbi temperaturat në territorin e Shqipërisë paraqitet në grafikun e dhënë në figurën Nr.4 dhe në Nr.7/1÷12.

Globally, the month of December 2021 was 0.32°C warmer than the 1991÷2020 average for this month. It was the sixth warmest December on record, although only marginally colder than the December of 2016 and 2018 and close to 0.2°C cooler than December 2015 and 2019, the warmest December. Based on this information, our country was generally with values closer to the norm (1991÷2020). More detailed information on temperatures in the territory of Albania is presented in the graph given in Figures No.4 and Nr.7/1÷12.




Figure Nr.3. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe anomalive të tyre për kontinentin European për muajin dhjetor 2021, sipas NOAA-s. / Values of mean air temperatures and their anomalies for the European continent for the month of December 2021, according to NOAA.




Figure Nr.4. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit dhjetor 2021 për Shqipërinë. / Values of mean air temperatures for some meteorological stations of December month 2021 for Albania.

Ndërkohë, anomali të temperaturës mesatare evropiane ishin përgjithësisht më të mëdha dhe më të ndryshueshme se anomali të globale.

Temperatura mesatare evropiane për muajin dhjetor 2021 ishte 0.21°C nën mesataren 1991÷2020 dhe dhjetori më i ftohtë që nga viti 2012. Pavarësisht nga kushtet më të ftohta se mesatarja, disa pjesë të Evropës Perëndimore përjetuan situata të nxehta rekord në fund të muajit.

In the meantime, the European-average temperature anomalies are generally larger and more variable than global anomalies.

The European-average temperature for December 2021 was 0.21°C below the 1991÷2020 average and the coldest December since 2012. Despite the colder-than-average conditions, several parts of western Europe did experience record-breaking warmth situations at the end of the month.




Figure Nr.5. – Pamje satelitore të vranësirave për muajin dhjetor 2021 mbi territorin e Shqipërisë, sipas burimeve të NASA-s. / Satellite views of cloudiness for the month of December 2021 above the territory of Albania, according to NASA source.

Gjatë muajit dhjetor 2021 dominuan vranësirat dhe ditët me reshje shiu dhe dëbore. Disa pamje satelitore të këtyre situatave dominuese janë paraqitur në figurën Nr.5.

During December 2021, cloudy skies and days with rain and snow-dominated. It showed some satellite images of these dominant situations in Figure No.5





Figure Nr.6. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin European për 5 javët e muajit dhjetor 2021, sipas NOAA-s. / Average values of air temperatures for European Continent for the 5 weeks of December 2021, according to NOAA.

Figure Nr. 7/1÷7/12 - Temperaturat ditore për disa vendmatje meteorologjike për muajin dhjetor 2021 në Shqipëri.
The daily temperatures for some meteorological stations for December month 2021 in Albania.






Figura Nr.8. - Vlerat e temperaturave maksimale ekstreme të ajrit për kontinentin European për 5 javët e muajit dhjetor 2021, sipas NOAA-s. / Extreme maximal values of air temperatures for European Continent for the 5 weeks of December 2021, according to NOAA.




Figura Nr.9. - Vlerat e temperaturave mesatare maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit dhjetor 2021 për Shqipërinë. / Values of mean maximal air temperatures for some meteorological stations of December month 2021 for Albania.




Figura Nr.10. - Vlerat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit dhjetor 2021 për Shqipërinë. / Values of maximal absolute air temperatures for some meteorological stations of December month 2021 for Albania.



Figura Nr.11. – Pamje e mjegullës, e pranishme në orët e pasdites në datë 30.12.2021 në Tiranë. / Views of fog presence on the evening hours on date 30.12.2021 in Tirana (photo: P. Zorba).

Anomalitë e temperaturave të ajrit në shkallë kontinentale për 5 javët e muajit dhjetor 2021 paraqiten në figurën Nr.6. Ndërkohë temperaturat maksimale të ajrit paraqiten në figurën Nr.8 për kontinentin Europian, ndërsa për Shqipërinë në figurën Nr.9 jepen të dhënat e disa vendmatjeve për temperaturat mesatare maksimale si dhe ato maksimale absolute në figurën Nr.10.

Anomalies of air temperatures on a continental scale for the 5 weeks of December 2021 are shown in Figure No.6. Meanwhile, the maximum air temperatures are presented in figure Nr.8 for the European continent, while for Albania in figure Nr.9 are given the data of some measurements for the average maximum temperatures as well as the absolute maximum ones in figure Nr.10.




Figura Nr.12. - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për kontinentin European për 5 javët e muajit dhjetor 2021, sipas NOAA-s. / Extreme minimal values of air temperatures for European Continent for the 5 weeks of December 2021, according to NOAA.

Sa i takon temperaturave minimale ato në shkallë kontinentale janë paraqitur në figurën Nr.12, ku hapësira e vendit tonë edhe në këto pamje evidentohet në periferinë e këtyre vlerave, pasi pjesa më e prekur nga temperaturat e ulta i takon asaj VL te Europës dhe zonave malore në përgjithësi.

Për Shqipërinë, përkundrejt anomalive më të larta me $+0.9^{\circ}\text{C}$ të vlerave maksimale të temperaturave të ajrit, e kundërta ndodhi me temperaturat minimale, të cilat shënuan një anomali të lehtë negative me vetëm -0.1°C , siç ato paraqiten dhe në figurën Nr.13. Gjithësesi duhet theksuar se vlerat përkatëse minimale absolute të paraqitura në figurën Nr.14 ishin brenda normalitetit të stinës dhe karakteristikave klimatike sipas zonave, si dhe nuk përcollën ndonjë rekord apo dukuri të dëmshme.

Regarding the minimum temperatures, those on the continental scale are presented in figure No.12, where the space of our country in these images is evidenced in the periphery of these values, as the part most affected by low temperatures belongs to that NW of Europe and areas mountainous in general.

For Albania, despite the higher anomalies with $+0.9^{\circ}\text{C}$ of the maximum values of air temperatures, the opposite happened with the minimum temperatures, which marked a slight negative anomaly with only -0.1°C , as they appear in figure No.13. However, it should be noted that the relevant absolute minimum values presented in Figure No.14 were within the normality of the season and climatic characteristics by areas, and did not convey any record or harmful phenomena.




Figura Nr.13. - Vlerat e temperaturave mesatare minimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit dhjetor 2021 për Shqipërinë. / Values of mean minimal air temperatures for some meteorological stations of December month 2021 for Albania.




Figura Nr.14. - Vlerat e temperaturave minimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit dhjetor 2021 për Shqipërinë. / Values of minimal absolute air temperatures for some meteorological stations of December month 2021 for Albania.

Reshjet atmosferike e muajit dhjetor 2021 shënuan shmangie të theksuara mbi normë. Në shkallë kontinentale dukshëm zona e gadishullit Ballkanik ishte me reshje më të theksuara. Në hartat në vijim Nr.15 dhe Nr. 16 paraqiten të dhënat e reshjeve për muajin dhjetor 2021 për kontinentin Europian dhe anomalite përkatëse për këtë muaj. Një informacion më i detajuar sa i takon reshjeve të shprehura në % në shkallë Europiane kundrejt normës (1991÷2020) paraqitet në figurën Nr.17.



Atmospheric precipitation of December 2021 marked deviations above the norms. On a continental scale, the area of the Balkan Peninsula was significantly heavier. In the following chapters, No.15 and No.16 presents the rainfall data for December 2021 for the European continent and the corresponding anomalies for this month more detailed information regarding the precipitation expressed in % in European scale are compared to the norm (1991÷2020) presented in figure No.17.





Figura Nr.15. - Reshjet për muajin dhjetor 2021 në kontinentin Europian dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981÷2010, sipas NOAA-s. / Rainfall for December 2021 at the European continent and their anomalies referring to the period 1981÷2010 according to NOAA.



Një informacion më i detajuar mbi vlerat e reshjeve për muajin dhjetor 2021 për zonën e gadishullit Ballkanit paraqitet në hartën e figurës Nr.16, ku dy zonat me më shumë reshje prekin dhe hapësirat në pjesën VP e JP të Shqipërisë.

More detailed information on precipitation on Balkan Peninsula for December 2021 is presented in Figure No.16, where areas with high precipitation includes also the NW and SE part of Albania.

Figura Nr.16. – Vlerat e reshjeve (në mm) për gadishullin Ballkanit për muajin dhjetor 2021. / The values of precipitation (in mm) for Balkan peninsula for the month of December 2021.




Figura Nr.17. – Reshjet në % kundrejt vlerave të normës për muajin dhjetor 2021 për kontinentin European. / The precipitations for December month 2021 compare to norm values for European continent in %.

Sa i takon Shqipërisë reshjet shënuan vlera mbi normë (1961÷1990) me rreth +32%. Në vijim në grafikun e dhënë në figurën Nr.18 paraqiten të dhënat e reshjeve për muajin dhjetor 2021 për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për zona e nënzona të ndryshme klimatike të vendit.

Regarding Albania, the precipitation marked values above the norms (1961÷1990) with about +32%. In the following graph given in the figureNo.18 are presented the precipitation data for December 2021 for some meteorological stations selected for different climatic zones and subzones of the country.




Figura Nr.18. – Lartësia e reshjeve për disa vendmatje meteorologjike të muajit dhjetor 2021 për Shqipërinë. / The amount of precipitations for some meteorological stations of December month 2021 for Albania.

Shpërnadrja e reshjeve të muajit dhjetor 2021 në territorin e Shqipërisë e bazuar në të dhënat e 91 vendmatjeve meteorologjike të digjitalizuara e përpunuara si dhe paraqitura në një hartë pas aplikimit të GIS janë dhënë në figurën Nr.21 ku evidentohen zonat JP dhe VP me më shumë reshje, të cilat e kalojnë dhe pragun e 300 mm. Zona JL e Shqipërisë u karakterizua me më pak reshje, të cilat për muajin dhjetor 2021 shënuan vlera nën 200 mm.

The distribution of precipitation in December 2021 in the territory of Albania based on the data of 91 digitized meteorological stations processed and presented in a map after the application of GIS are given in figure No.21, where the areas JP and VP are identified with more precipitation, which exceeds the threshold of 300 mm. The SE area of Albania was characterized by less rainfall, which for December 2021 marked values below 200 mm.





Figure Nr.19. – Numri i ditëve me reshjeve mbi pragun 1.0 mm për disa vendmatje meteorologjike për muajin dhjetor 2021 për Shqipërinë. / The number of days with precipitations over the threshold 1.0 mm for some meteorological stations of December month 2021 for Albania.



Ndërkohë tregues të tjerë si ai numrit të ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm është paraqitur në grafikun e figurës Nr.19 dhe në hartën e dhënë në figurën Nr.20, ndërsa për ditët me reshje mbi pragun 10.0mm të dhënat janë paraqitur në hartën e dhënë në vijim në figurën Nr.22 dhe grafikun në figurën Nr.24.

Meanwhile, other indicators such as the number of rainy days above the 1.0 mm threshold are presented in the graph of figure No.19 and in the map given in figure No.20, while for rainy days above the 10.0mm threshold the data are presented in the map given below in figure No.22 and the graph on figure Nr.24.

Figura Nr.20. – Numri i ditëve me reshjeve mbi pragun 1.0 mm për muajin dhjetor 2021 për Shqipërinë. / The number of days with precipitations over the threshold 1.0 mm for December month 2021 for Albania.






Figura Nr.22. – Numri i ditëve me reshjeve mbi prapun 10.0 mm për muajin dhjetor 2021 për Shqipërinë.
The number of days with precipitations over the threshold 10.0 mm for December month 2021 for Albania.



Për rëndësinë që kanë reshjet e këtij muaji një analizë më e thelluar nuk mund të mos lë pa evidentuar dhe situatën e reshjeve jashtë territorit të Shqipërisë, e cila siç dihet ka një sipërfaqe të pellgu ujëmbledhës rreth 44 mijë km². Për rrjedhojë dhe situata hidrike në vendin tonë nuk mund të mos ndikohet, siç është shënuar dhe në të shkuarën nga reshjet e vrojtuar në këto hapësira. Në vijim në figurën Nr.23 paraqitet situata me reshje të larta në zonën VP të Greqisë pranë pjesës JL të Shqipërisë, e cila edhe në shkallë kontinentale dallon për këto reshje. Po ashtu vlen të evidentohet dhe situata për periudhën 22÷28 dhjetor 2021 dhënë në hartën e figurës Nr.25.

For the importance of this month's rainfall, a more in-depth analysis cannot leave without identifying the situation of rainfall outside the territory of Albania, which as it is known has a catchment area of about 44 thousand km². Consequently, the hydric situation in our country cannot be unaffected, as evidenced in the past by the rainfall observed in these areas. The following figure No.23 shows the situation with high rainfall in the NW area of Greece near the SE part of Albania, which also on a continental scale differs for this rainfall. It is also worth noting the situation for the period 22÷28 December 2021 given in the figure No.25.







Figura Nr.24. – Numri i ditëve me reshjeve mbi pragu 10.0 mm për disa vendmatje meteorologjike për muajin dhjetor 2021 për Shqipërinë. / The number of days with precipitations over the threshold 10.0 mm for some meteorological stations of December month 2021 for Albania.



Në vijim në figuren Nr.26 paraqiten të dhënat e reshjeve maksimale 24 orëshe për Shqipërinë për muajin dhjetor 2021, ku vlerat më të larta janë vërejtur në pjesën JP të vendit, ndërsa në hartën e dhënë në figurën Nr.27 paraqiten të dhënat për reshjet e vërejtura më datë 27 dhjetor 2021.

The following figure shows the maximum rainfall data for 24 hours for Albania for the month of December 2021, where the highest values are observed in the SW part of the country, while the map given in figure No.27 presents the data on precipitation observed on December 27, 2021.




Figure Nr.26. – Lartësia maksimale 24 orëshe e reshjeve për muajin dhjetor 2021 për Shqipërinë. / The 24-hour maximal precipitation values of December month 2021 for Albania.




Figure Nr.27. – Lartësia e reshjeve 24 orëshe në datën 5 dhjetor 2021 për Shqipërinë. The 24-hour precipitation values of December 5, 2021 for Albania.




Figura Nr.28. - Reshjet maksimale 24 orëshe për muajin dhjetor 2021 në disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë. / Maximal 24 hours rainfall for the month of December 2021 to some meteorological stations f Albania.

Në vijim në figurën Nr.29 paraqiten të dhënat e reshjeve të muajit dhjetor 2021 në % kundrejt vlerave të normës.

The following in figure No.29 are presented the precipitation data of December 2021 in % against the norm values.




Figura Nr.29. – Reshjet në % kundrejt vlerave të normës për muajin dhjetor 2021 për Shqipërinë.

The precipitations for December month 2021 compare to norm values for Albania in %.

Dëbora gjatë muajit dhjetor 2021 ishte e pranishme në vlera të moderuara si sa i takon shtresës së saj ashtu dhe zonës së mbulimit. Në vijim në grafikun e figurës Nr.31 paraqiten lartësitë maksimale të dëborës të regjistruara në disa vendmatje meteorologjike. Një pamje e dëborës në lartësitë mbi 1000 metra mbi niveilin e detit për vargmalin Dajt-Priskë në VL të Tiranës për datën 11.12.2021 paraqitet në figurën Nr.30, ndërsa një pamje satelitore për datën 21 dhjetor 2021 jepet në figurën Nr.32.

Snow during December 2021 was present in moderate values both in terms of its layer and coverage area. The following is the graph in Figure No.31 showing the maximum snow heights recorded in some meteorological stations. A picture of snow at altitudes above 1000 meters above sea level for the Dajt-Priske range in the NE of Tirana for 11.12.2021 is shown in figure No.30 while a satellite image for the date 21 December 2021 is given in figure No.32.





Figura Nr.31. – Lartësia e dëborës në disa vendmatje meteorologjike për muajin dhjetor 2021. / The snow level in some meteorological stations for December month 2021.



*Figure Nr.32 – Mbulesa e
dëborës më datë 21 dhjetor
2021 mbi Shqipërinë (NOAA).*

*Snow cover on date December
21, 2021 over Albania
(NOAA).*

Një vlerësim mbi ritmet e shkrirjes së dëborës përgjatë muajit dhjetor 2021 për çdo 4 ditë në territorin e Shqipërisë sipas platformës SEEFFG paraqitet në figurën Nr.33. Nga ky informacion shihet qartë jo vetëm zonat e prekura nga dëbora, por dhe ritmet e shkrirjes së saj.

An assessment of the rates of snow melting during December 2021 for every 4 days in the territory of Albania according to the SEEFFG platform is presented in figure No.33. From this information, it is clear not only the area affected by the snow but also the rates of its melting.




Figure Nr.33. – Vlerësimi i ritmeve të shkrirjes së dëborës çdo ditë, për 4 ditët në vijim sipas platformës “SEEFFG” për muajin dhjetor 2021. The estimations of snow melting rate every day for the next 4 days according to the platform “SEEFFG” for December month 2021.




Figure Nr.34. Vlerësimi i reshjeve të pritshme çdo ditë, për 24 orët në vijim sipas platformës “SEEFFG” për muajin dhjetor 2021. / The estimation for the expected precipitation on the next 24 hours according to the platform “SEEFFG” for December

Të dhënat mbi reshjet e parashikuara 24 orëshe janë një informacion i rëndësishëm për të ri-analizuar situatën mbizotëruese me reshje për muajin dhjetor 2021, të cilat sipas produkteve të platformës SEEFFG, janë paraqitur në figurën Nr.34.

The forecast data on 24-hour precipitation is an important information to re-analyze the prevailing precipitation situation for December 2021, which according to the products of the SEEFFG platform, are presented in Figure No.34.

Agrometeorologji.

Muaji dhjetor 2021 shënoi dhe mbarimin e periudhës së vegjetacionit në një pjesë të madhe të vendit, tashmë e vonuar në kohë, ashtu siç ka ndodhur mjaft herë në vitet e fundit. Në vijim një paraqitje grafike për datën e fillimit dhe të mbarimit të periudhës së vegjetacionit për vendmatjen meteorologjike të Tiranës jepet në figurën Nr.35. Kjo periudhë ndonëse pati një fillim më të vonë këtë vit ndryshe nga vitet fundit, për vitin 2021 shënoi një mbarim më të vonë, e cila e krahasuar me vlerat e normës ishte 11 ditë më e vonshme.



Agrometeorology.

The month of December 2021 marked the end of the vegetation period in a large part of the country, already late, as has happened many times in recent years. The following is a graphic presentation of the date of beginning and end of the vegetation period for the meteorological station of Tirana is presented in figure No.35. This period, although it had a later beginning this year, unlike the previous years, for 2021 marked a later end, which compared to the norm values was 11 days later.




Figure Nr.35. – Vlerat ditore të temperaturave maksimale, minimale e mesatare ditore të ajrit së bashku me reshjet përgjatë vitit 2021 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës. The daily maximal, minimal and mean air temperatures during the year 2021 for the meteorological station of Tirana.





Figure Nr.36. – Treguesi i shumës së temperaturave aktive të ajrit mbi pragu 10°C për muajin dhjetor 2021 në disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë. / The index of the sum of active air temperatures above the threshold 10°C for December month 2021 at some meteorological stations of Albania.

Natyrishit në zonat urbane duke qenë paksa më ngrohtë, siç kjo është evidentuar herë pas here dhe në faqet e këtij buletini, për Tiranën në veçanti, vegetacionit i ofrohet dhe një kohëzgjatje më e madhe duke mundësuar plotësimin e nevojave fiziologjike për specie më ngrohtësi dashëse. Në vijim

një paraqitje skematike nga literatura dhënë në figurën Nr.37 paraqet faktin që në zonat urbane vrojtohet një fillim më i hershëm dhe mbarim më i vonshëm i vegetacionit. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe shënohet dhe një tregues i Shumës së Temperaturave Aktive mbi pragun 10°C më i lartë. Për Tiranën gjatë vitit 2021 u shënuar një vlerë e $\sum TA > 10^\circ C$ prej 5127.5°C, ndërsa vlera e $\sum TE > 10^\circ C$ shënoi madhësinë 2697.5°C, të cilat respektivisht kundrejt normës ishin +12% dhe +26%. Ndërkohë, periudha e vegetacionit u karakterizua me një temperature mesatare të ajrit prej 20.6°C si dhe 470.6 mm reshje, të cilat kundrejt totalit vjetor prej 1346.0 mm përbën veçse 35% të kësaj vlere, ndonëse në tërësi reshjet vjetore shënuan një vlerë më të lartë se norma me +12.3% për Tiranën; por me një shpërndarje jo uniforme duke mbizotëruar me anomali të theksuara mbi normë në muajt janar dhe dhjetor 2021. Nga një vështrim i shpejtë në shkallë kombëtare për reshjet gjatë vitit 2021 referuar ecurisë mujore, siç ajo është paraqitur grafikisht në figurën Nr.38, rezulton se periudha e vegetacionit përgjithësisht karakterizohet me anomali negative, ndonëse në totalin e tyre vjetor reshjet ishin pranë vlerave të normës.



*Figure Nr.37. - Pamje skematike mbi periudhën e vegetacionit në mjediset e klimes urbane.
A schematic views of growing season at the environment of urban climate.*

Of course, in urban areas being slightly warmer, as this has been evidenced from time to time and in the pages of this bulletin, for Tirana in particular, the vegetation is offered a greater duration enabling the fulfillment of physiological needs for species with warmth. The following is a schematic presentation of the

literature given in figure No.37. represents the fact that in urban areas an earlier beginning and later end of vegetation is observed.

Also, during this period there is an indicator of the Sum of Active Temperatures above the 10°C thresholds. For Tirana during 2021 a value of $\sum TA > 10^\circ C$ of 5127.5°C was recorded, while the value of $\sum TE > 10^\circ C$ marked the value of 2697.5°C, which respectively against the norm were +12% and +26%.

Meanwhile, the vegetation period was characterized by an average air temperature of 20.6°C and 470.6 mm of rainfall, which compared to the annual total of 1346.0 mm accounted for only 35% of this value, although in general, the annual rainfall marked a higher value; that the rate with +12.3% for Tirana, but with a non-uniform distribution prevailing with pronounced anomalies above the rates in January and December 2021. From a quick view on a national scale for precipitation during 2021 referring to the monthly performance, such as is presented graphically in figure No.38, it turns out that the vegetation period is generally characterized by negative anomalies, although their total annual rainfall have been around the norm values.




Figure Nr.38. – Ecuria e reshjeve sipas muajve gjatë vitit 2021 për Shqipërinë dhe vlerat respektive të normës. / The ongoing of monthly precipitation during the year 2021 for Albania and the respective norm values.

Kalimi i qëndrueshëm i temperaturave të ajrit nën pragun 10°C gjatë muajit dhjetor 2021 u shoqërua dhe me praninë e ngricave dhe në zonën e ulët të vendit që është dhe zona kryesore bujqësore e vendit e po ashtu ato ishte prezente dhe në fushën e Korçës.

Në fushën e Korçës me datë 22 nëntor 2021 u shënua fundi i periudhës së vegetacionit ndërkohë “ngrica e parë e vjeshtës” u shënua pikërisht me 1 dhjetor 2021. Periudha e vegetacionit për Korçën zgjati gjatë vitit 2021 212 ditë dhe u krakterizua me një temperaturë mesatare të ajrit prej 16.7°C. Ajo ishte më e gjatë se norma me rreth 28 ditë dhe mbaroi me një vonesë prej 3 javësh.

Gjatë kësaj periudhe u grumbullua një Shumë e Temperaturave Aktive mbi pragun 10°C prej 3759.8°C dhe $\sum TE > 10^\circ C$ prej 1819.8°C, të cilat respektivisht kundrejt vlerave të normës ishin +27% dhe +50%, ndërkohë që kjo periudhë u karakterizua me një vlerë të reshjeve prej 527.3mm ose rreth 54% të reshjeve vjetore, që u vrojtun gjatë këtij viti në këtë zonë (shih dhe figurën Nr.36).

The steady passage of air temperatures below the threshold of 10°C during December 2021 was accompanied by the presence of frosts in the lowland area of the country which is the main agricultural area of the country and it was also present in the Korça plain.

